

Shkollat në Kantonin e Aargaut



Informacione për prindër (albanisch)

**DEPARTEMENT
BILDUNG, KULTUR UND SPORT**
Abteilung Volksschule

Botuesi

Departement
Bildung, Kultur und Sport
Abteilung Volksschule
Bachstrasse 15
5001 Aarau

Tel. 062 835 21 00

E-Mail: volksschule@ag.ch
www.ag.ch/volksschule

Fotot

fotolia
Kanton Aargau

Copyright

© 2016 Kanton Aargau

Hyrje

Me këtë broshurë ne dëshirojmë që ju t`iu japim informacionet më të rëndësishme për sistemin shkollor në kantonin e Aargaut. Këto njohuri do të duhej që t`iu ndihmojnë ju që t`i mbështesni fëmijët tuaj me rastin e hyrjes apo pas hyrjes në shkollë në kantonin e Aargaut.

Mbas një vështrimi mbi strukturën e shkollës fillore 9 vjeçare në kantonin e Aargaut, do t`i përshkruajmë pjesët përbërse të kësaj strukture. Më fjalë do të përshkruhen nivelet e ndryshme të shkollës dhe llojet e shkollës, masat mbështetëse plotësuese dhe qendrat këshilluese përkatëse, po ashtu oferta të tjera në lidhje të përbashkët me arsimimin profesional dhe shkollat e tjera eksistuese.

Një pikë e rëndësishme për suksesin në shkollë është puna e përbashkët në mes shkollës dhe prindërve. Punës të përbashkët i është kushtuar një kapitël i veçant.

Në fund të çdo përshkrimi janë të dhëna internetlinks, numrat e telefonit dhe adresat kontaktuese. Informacione të tjera ju ofrohet ju me rastin e mbledhjeve informative për prindër. Sapo fëmiju juaj të hyj në kopshtin parashkollor apo në shkollë, për pyetjet e mundshme individuale që ju mund të keni, janë në dispozicion tuaj personeli mësimor si dhe udhëheqësit e shkollës përkatëse.

Ne i dëshirojmë fëmijut tuaj një fillim të mbarë në shkollë në kantonin e Aargaut.

Departamenti për Arsimim, Kultur dhe Sport
Sektori shkolla fillore 9 vjeçare

Vështrim mbi sistemin shkollor në kantonin e Aargaut/Shkolla fillore 9 vjeçare Volksschule

Të gjithë fëmijët dhe të rinjët, që jetojnë në kantonin e Aargaut janë të detyruar të shkojnë në shkollë. Detyrimi shkollor zgjatë 11 vjet. Ai fillon me mbarimin e vitit të katërt të jetës. Viti shkollor fillon gjithmonë në të hënën e dytë të muajit gusht.

Koha shkollore e detyruar

Koha shkollore e detyruar përbëhet nga tri nivele.

Kopshti parashkollor zgjatë 2 vjet **Kindergarten**

Shkolla fillore e ultë zgjatë 6 vjet **Primarschule**

Shkolla fillore e lartë zgjatë 3 vjet **Oberstufe** (niveli Sekundar I) zgjatë 3 vjet. Ajo është e ndarë në llojet e shkollës Reale, Sekundare dhe atë Bezirk (Rajonale) Realschule, Sekundarschule dhe Bezirksschule

Ka edhe forma të tjera të shkollës, që janë paraparë për fëmijë me nevoja të veçanta, si klasët e vogla apo klasa e parë që zgjatë 2 vjet. Detalet për këtë mund të lexohen në kapitullin “(Primarschule” dhe “Oberstufe Sekundarstufe I”).


Shkollimi i veçantë

Fëmijët dhe të rinjët me nevoja të veçanta mbështeten me masa të veçanta. Mbështetja me masa pedagogjike të posaçme rrjedhë e integruar (në kornizën e shkollës të rregullt) apo ndaras, (në klasët e vogla). Ka edhe shkolla tjera të veçanta.

Sistemi Federal

Sistemi shkollor në Zvicër është i ndërtuar në mënyrë federale. Secili kanton ka sistemin e vetë shkollor. Përgjegjësia kryesore për shkollën qëndron në kantone (ligjet për shkollën) dhe në komuna (zbatimi). Për arsimimin profesional përgjegjëse është federata.

Paraqitja e mëposhtme jep një vështrim mbi ndërtimin e shkollës fillore 9 vjeçare të detyruar në kantonin e Aargaut. Grafika është e dhënë nga poshtë dhe lexohet nga poshtë (hyrja në shkollë) deri lart (dalja nga shkolla).



WJ: Vit punëtorieWerkjahr (Ofertë për të rinjët nga klasët e vogla dhe të shkollës Reale)

BWJ: Vit i zgjedhjes të profesionit Berufswahljahr (Ofertë për të rinjët nga shkolla Reale- Sekundare dhe shkolla Rajonale, po ashtu edhe nga klasët e vogla)

IBK: Klasa për integrim dhe gjetjen e profesionit Integrations- und Berufsfindungsklasse (viti i 11. shkollor për të rinjët që maksimalisht janë në Zvicër 2 vjet dhe që detyrimin shkollor në vendlindje e kanë plotësuar pjesërisht apo plotësisht.)

Informacione të rëndësishme për shkollën filllore 9 vjeçare

Kur e ndërroni vendbanimin...

Pyetni zyrtarët në komunë ku duhet t'i lajmëroni fëmijët për shkollë. Ju mund t'i drejtoheni direkt udhëheqësisë të shkollës të komunës tuaj.

Në përgjithësi

Mësimi në shkolla publike gjatë shkollimit të detyruar është falas. Komunitat ju japin nxënëseve dhe nxënësve mjetet dhe materialin shkollor falas.

Shkolla publike për nga feja është neutrale. Ajo nuk guxon ta kufizoj as besimin as lirinë e të menduarit, si dhe të drejtën e prindërve për edukim e cila është e mbrojtur sipas përpilimit të kushtetutes.

Djemët dhe vajzat mësojnë së bashku. Ata ndjekin lëndët e njëjta.

Autoritetet e shkollës

Shkolla- dhe arsimimi në kantonin e Aargaut udhëhiqet nga Departamenti për Arsimim Kultur dhe Sport. Departement Bildung, Kultur und Sport (BKS)

Për ndërmarrjen e shkollës janë përgjegjëse në çdo komunë udhëheqësia dhe pleqësia e shkollës. Pleqësia e shkollës zgjedhet nga vota e banorëve të komunës përkatëse. Udhëheqësia e shkollës vendoset nga pleqësia e shkollës.

Dëftesat dhe kalimet

Në kopshtin parashkollor marrin prindërit dhe fëmijët në fund të vitit shkollor një pyetësor të vlerësuar me shkrim. Kjo jep të dhëna mbi zhvillimin e fëmijëve.

Në klasën e parë dhe në klasën e parë që zgjatë dy vjet të shkollës fillore të ulët, fëmijët e marrin në fund të vitit shkollor një raport të ndërmjetëm dhe në fund të vitit shkollor një vlerësim të suksesit me fjalë.

Prej klasës të 2 të shkollës fillore të ulët dhe deri në vitin e 3-të të shkollës fillore të lartë marrin të gjithë nxënëset dhe nxënësit në mbarim të gjysëmvetorit të parë një raport të ndërmjetëm me nota orientuese dhe në fund të vitit shkollor një dëftesë vjetore me nota. Nota më e mirë është 6 kurse më e dobëta 1.

Të dhënat e hollësishme janë të dhëna në broshurën „Vlerësimi i suksesit dhe kalimi në shkollën fillore 9 vjeçare Aargau“.

Informacione të tjera: www.ag.ch/leistungsbeurteilung-volksschule

Vijimi i rregullt në shkollë

Prindërit apo përfaqësuesit e fëmijëve të tyre janë të detyruar që fëmijët t'i dërgojnë rregullisht në shkollë. Kur një fëmijë për të cilin prindi apo kujdestari është përgjegjës që ai ta vijoj shkollën, poqëse nuk e dërgon në shkollë mund të ndëshkohet me gjobë.



Mungesat e pa parashikuara

Prindërit dhe përfaqësuesit e tyre e informojnë personelin mësimor menjëherë nëse fëmiju i tyre mungon në shkollë dhe duhet ta tregojnë arsyen e mungesës. Personeli mësimor mund të kërkoj nga ju që të kërkonit falje me shkrim. Si arsyetim për mungesa vlenë posaçërisht:

- Kur fëmiju është i sëmurë
- Rast vdekje në familje

Mungesat e paarsyetuara në shkollën fillore të lartë Rajonale-, Sekundare-dhe Reale (Bezirks-, Sekundar-und Realschule) shënohen në raportin e ndërmjetëm dhe dëftesën vjetore.

Lirim nga detyrimi mësimor

Ligji shkollor në kantonin e Aargaut ju lejonë prindërve, që të paraqesin me shkrim kërkesë që ta marrin një gjysmë dite për tremujor (pa të dhëna te posaçme të arsyes) për fëmijët e tyre. Ju mundeni edhe dy gjysëm dite si një ditë të vetme për një gjysëmvetor ta shfrytëzoni (leja përmes pleqësisë të shkollës).

Për mungesa të tjera të parashikuara duhet te pleqësia e shkollës Schulpflege apo te udhëheqësia e shkollës e caktuar nga pleqësia e shkollës apo te personeli mësimor të bëhet më parë kërkesa me shkrim. Arsyetim për lirim nga detyrimi mund të jenë: Pjesëmarrje aktive në sport, ditë fetare të veçanta, punë provuese dhe të ngjashme. Edhe te nevoja të jashtëzakonshme për mbështetje për talente të veçanta mundet një lirim nga detyrimi shkollor të bëhet nga shkolla, përderisa nuk bëhet fjalë për një lirim nga detyrimi gjatë nga një lëndë. Lirim nga detyrimi shkollor më të gjatë mund të lejohet vetëm nga Departamenti Departement BKS.

Gjatë vitit të parë në kopshtin parashkollor pleqësia e shkollës guxon maksimalisht vetëm një gjysëmdite me kërkesë të prindërve për një javë ta lejojë.

Datat e pushimit

Datat e pushimi ndryshojnë diç prej komune në komunë. Njoftimin për datat e pushimit në komunën tuaj ju jap shkolla. Datat e pushimit mund t'i gjeni dhe në adresën e mëposhtme në internet:

Informacione të tjera: www.schulen-aargau.ch > Schulen

Mjeku i shkollës/mjeku i dhëmbëve i shkollës

Shërbimi i mjekëve të shkollës i mbikqyrë kushtet shëndetësore në shkollë. Ai bënë te fëmijët vizitat mjekësore. Këto vizita mjekësore shërbejnë për të përcaktuar me kohë nëse ka pengesa shëndetësore si në dëgjim, në të pamurit dhe të folurit, apo pengesa në qëndrim dhe lëvizje. Nëse te fëmiju gjendet diçka e tillë, mjeku i shkollës i njofton prindërit dhe bisedon me ta ecurin e mëtejme.

Prej vitit të parë në kopshtin parashkollor e deri në klasën e 3. të shkollës fillore të lartë marrin nxënëset dhe nxënësit një fletore me fletë me vlerë për vit. Me këtë mundën sipas zgjedhjes të tyre të një mjeku të dhëmbëve t'i kontrollojnë dhëmbët.

Njoftime dhe informacione të tjera:

Nëse keni pyetje, drejtohuni më s'miri mësuesit apo mësueses të fëmijës tuaj.

Informacione për nivelet e ndryshme shkollore dhe shkolla mund të gjeni në internet në adresën e mëposhtme: www.ag.ch/bks

Njoftime për kopshtin parashkollor, shkollën fillore të ulët dhe shkollën fillore të lartë mund të gjeni edhe këtu:

Departement Bildung, Kultur und Sport
E-Mail: volksschule@ag.ch; Tel. 062 835 21 00



Puna e përbashkët shkollë - prindër

Detyrat e shkollës

Sipas ligjit shkolla duhet të ndërmarrë çdo gjë që fëmiju të zhvillohet shëndosh. Këtu vlen, që fëmijët dhe të rinjtë gjatë shkollimit të mbesin të padëmtuar. Shëndeti është po ashtu një parakusht për suksesin në shkollë.

Shkolla është e detyruar, për ngjarjet në shkollë dhe suksesin e fëmijës tuaj t`iu informoj rregullisht. Për këtë bëhen mbledhjet e prindërve, biseda të veçanta me prindër si dhe mbledhjet e ndryshme informative. Nëse ndiheni pak i informuar, pyetni personelin mësimor apo udhëheqësin e shkollës.

Të drejtat dhe detyrat e prindërve

Si prindë keni përgjegjësin që fëmiju juaj ta vijoj shkollën rregullisht. Prej jush pritet po ashtu që të përkujdeseni që fëmiju juaj t`i kryej detyrat e shtëpisë dhe që ta dërgoni të pushuar në shkollë. Me atë që punën dhe detyrat e shkollës të fëmijut tuaj rregullisht i shikoni, tregoni ju interesim në zhvillimin shkollor dhe kështu mbështesni ju fëmijun tuaj.

Vëreni ju lutemi, që ju keni detyrim, ftesat e pleqësis të shkollës apo shkollës (udhëheqësia dhe personeli mësimor) mbledhjet e prindërve apo bisedave tu përgjigjeni dhe të merrni pjesë.

Mirëmbani kontakt me mësuesen me mësuesin e vajzës, djalit tënd. Nga një punë e ngushtë e përbashkët në mes të prindërve dhe shkollës, fëmiju juaj mund të përfitoj në atë që optimalisht të nxitet.

Si prindër e keni të drejtën, të vizitoni fëmijun tuaj në mësim. Ju lutemi që ta lajmëroni më parë personelin mësimor.

Para vendimeve të rëndësishme keni të drejtë për mbledhje dëgjimore dhe qasje në akte të fëmijës tuaj. Vendimi definitiv duhet të ju vij nga autortetet e shkollës me shkrim dhe i argumentuar. Nëse nuk jeni të pajtimit me këtë vendim, keni në shumicën e rasteve mundësi të këshilli rajonal i shkollës Bezirksschulrat ta dërgoni një ankesë. Shembuj për vendime të rëndësishme me të drejtë dëgjimi dhe të drejtën për ankesë janë:

Hyrja në kopshtin parashkollor

Hyrja në klasën e parë në shkollën fillore të ulët

Vendimi për mbështetje me pedagogji shëruese, në klasën e parë që zgjatë dy vjet, klasa e vogël etj.

Kalimi në shkollën fillore të lartë

Kalimi, ndërrimi i llojit të shkollës në shkollën fillore të lartë etj.

Dërgimi në shkollë të veçantë

Te kush mund të drejtohen prindërit kur kanë pyetje apo për probleme me shkollë?

Flisni me personelin mësimor të fëmijut tuaj.

Drejtohuni te udhëheqësia e shkollës.

Drejtohuni te pleqësia e shkollës.

Nëse jeni të mendimit, që kërkesat tuaj jo korrekt dhe shumë pak merren parasysh, mundeni si mundësi e katërt të radhës t'i drejoheni sektorit për mbikqyrje të shkollës (Sektion Schulaufsicht).

Kontakti: Sektori mbikqyrja e shkollës (Sektion Schulaufsicht). Tel. 062 835 21 05. E-Mail: sa.volksschule@ag.ch
www.ag.ch/schulaufsicht

Vëreni ju edhe ofertat e këshillimoreve për kërkesa të ndryshme (kapitulli “ shërbimet këshilluese”).

Kopshti parashkollor(2 vjet) Kindergarten

Hyrja në kopshtin parashkollor

Vijimi në kopshtin parashkollor është i detyruar.

Fëmijët, të cilët deri më 31 korrik¹ kanë mbushur katër vjet, hyjn me fillimin të vitit tjetër shkollor d.m.th. në gusht në kopshtin parashkollor.

Fushat e mësimi

Vijimi i kopshtit parashkollor e ndihmon fëmijun në përgjithësi në zhvillimin e tij. Në kopshtin parashkollor fëmijët e kanë mundësinë në një rreth të ri interesat dhe talentin e tij ta zhvillojë tutje. Të mësuarit ndodhë nëpërmes lojës dhe vendos bazën për shkollë me shpalosjen e aftësive të gjuhës, matematikës, lëvizjeve, jetës shoqërore dhe të emocioneve.

Fëmijët të cilët interesohen për lexim, shkrim dhe njësime do të jenë të mbështetur. Mirëpo nuk ka mësim sistematik në lexim, shkrim, dhe njësime. Nëse një fëmijë është shumë i talentuar mundet parakohe të kalojë në klasën e parë

Fëmijët të cilët në shtëpi nuk flasin gjermanisht do të kenë mbështetje në mësimin e gjuhës gjermane.

Fëmijët me probleme në zhvillim do të kenë në kopshtin parashkollor mbështetje nga personi mësimor për pedagogji shëruese.

¹ Definitivisht vlen prej 31 korriku 2018. Deri në këtë kohë është në kompetencën e komunave që datën e hyrjes në shkollë e cila deri më tani ka qenë 30. Prill hap pas hapi ta përshtasin më 31 korrik.

Shkolla fillore e ulët Primarschule (1. deri në klasën e 6.)

Shkolla fillore e ulët klasa e rregullt

Shkolla fillore e ulët përbëhet prej klasës të parë deri në klasën e gjashtë.

Në vitet e para shkollore ushtrohen aftësit në lexim, shkrim, dhe njësime. Gjatë të mësuarit në klasë, nxitet kuptimi i punës të përbashkët si dhe forcohet personaliteti i fëmijës. Përkujdesje kanë edhe fushat si muzika, vizatimi, puna me tekstil, lëvizja dhe sporti. Temat me përmbajtje të njohurive nga natyra ndërmjetësohen sipas moshës të fëmijëve.

Në mësim merren parasysh aftësit e ndryshme të mësuarit si dhe nevojat e nxënësve dhe nxënësve. Një qëllim i rëndësishëm i shkollës fillore të ulët është nxitja e pavarësisë, vetëpërgjegjësisë dhe mësimi në shoqëri i fëmijëve.

Klasa e parë- dy vjet Einschulungsklasse

Fëmijët, të cilët nuk i përmbushin kërkesat për klasën e parë, mund të shkojnë në klasën e parë që zgjatë dy vjet. Materiali mësimor i klasës të parë të rregullt ndahet në dy vjet. Mbas mbarimit të klasës të parë që zgjatë dy vjet, zakonisht fëmijët shkojnë në klasën e dytë të rregullt të shkollës fillore të ulët.

Pedagogji shëruese / Klasa e vogël shkolla fillore ulët / Heilpädagogik Kleinklasse

Në shumicën e shkollave është e integruar pedagogja shëruese. Kjo do të thotë, që fëmijët me vështësi në mësim të cilët e vijojn klasën e rregullt, mbështeten nga një person mësimor i arsimuar për pedagogji shëruese. Nëse është e nevojshme fëmijët e marrin një plan nxitës personal me qëllime individuale të mësimi.

Në pak shkolla ka klasa të vogla për mbështetje të fëmijëve me vështësi në mësim, ku në përmes një personi mësimor i arsimuar për pedagogji shëruese ata ndihmohen. Këtu është numri i nxënësve më i vogël se në klasët e rregullta, qëllimet mësimore përkujdesje me planin mësimor të klasës të rregullt.

Shkolla fillore e lartë/niveli Sekundar I (7.deri klasa e 9.) Oberstufe

Shkolla fillore e lartë ndahet në tri lloje të shkollës. Shkolla Reale Realschule, shkolla Sekundare Sekundarschule dhe Shkolla Rajonale Bezirksschule. Këto tri lloje të shkollave dallohen nga kriteret e suksesit të nxënësve dhe nxënësve. Të tria llojet e shkollës zgjasin tri vjet.

Kalimi prej shkollës fillore të ulët në shkollën fillore të lartë/ndërrimi në një lloj tjetër të shkollës

Caktimi i nxënësve dhe nxënësve në njëren prej tri llojeve të shkollës bëhet nga mësuesi i klasës së 6. pas bisedës me prindër. Nëse prindërit dhe mësuesi nuk janë të një mendimi, vendos pleqësia e shkollës.

Nxënëset dhe nxënësit e aftë dhe të motivuar mund të kalojnë në lloj tjetër të shkollës. Parakusht është propozimi i personelit mësimor dhe një vendim i pleqësis të shkollës. Ndërrimi bëhet sipas rregullit në fund të vitit shkollor.



Shkolla Reale (Realschule)

Shkolla Reale është lloji i shkollës fillore të lartë me kërkesa më të pakta për mësim. Në shkollën Reale fitojnë nxënëset dhe nxënësit një arsimim të gjerë të përgjithshëm dhe një bazë për një mësim zanati me kërkesa themelore. Mbas shkollës Reale mësojnë shumica e të rinjve një profesion zejtar apo industrial.

Te suktesi i mirë në mësim si dhe gjatë mësimin të një zeje, shkollat profesionale ju ofrojnë të rinjve shumë mundësi të arsimimit të mëtejshëm si dhe ngritje në profesion.

Shkolla Sekundare (Sekundarschule)

Shkolla Sekundare është lloji i shkollës fillore të lartë me sukses të mesëm. Ajo ndërmjetëson dhe përgatit në arsimim të përgjithshëm si dhe forcon parakushtet për një arsimim profesional të avancuar. Nxënëset dhe nxënësit shkojnë pas shkollës sekundare në shkollë të mesme pedagogjike, mjekësisë, artit, gazetarisë dhe në shkollën për punë sociale (die Fachmittelschule) në shkollën e mesme ekonomike (Wirtschaftsmittelschule) apo në shkollën e mesme të informatikës (Informatikmittelschule).

Informacione për kushtet e pranimit në këto shkolla shiko kapitullin "Mittelschulen (Sekundarstufe II)"

Shkolla Rajonale (Bezirksschule)

Shkolla Rajonale është lloji i shkollës që kërkon rezultatet më të larta në mësim. Ajo përgatit për një profesion të avancuar si dhe për shkollat e mesme (gjimnaz / shkollë profesionale / shkollë e mesme ekonomike / shkolla e mesme e informatikës. Gati gjysma e absolventeve dhe absolventve bëjnë një profesion prej zejтари, industrie apo shërbime publike të ndryshme. Të tjerët shkojnë në një shkollë të mesme.

Informacione për kushtet e pranimit në gjimnazë, në shkollat e mesme drejtimi pedagogji, mjekësi, gazetari, art , punë sociale, shkolla e mesme ekonomike si dhe ajo e informatikës shiko kapitullin "Mittelschulen (Sekundarstufe II)"

Pedagogjia shëruese e integruar klasa e vogël shkolla fillore e lartë

Në shumicën e shkollave ka pedagogji shëruese të integruar. Kjo do të thotë që të rinjtë me vështërsi në mësim i vizitojnë klasët e rregullta. Ata mbështeten në mësim nga një peson mësimor i arsimuar për pedagogji shëruese. Nëse është e nevojshme ata marrin një plan personal nxitës me qëllime individuale të mësimin.

Në disa shkolla ka klasë të vogla për mbështetje të të rinjve me vështërsi në mësim. Numri i nxënëseve dhe nxënësve këtu është më i vogël se në klasët e rregullta. Nxënëset dhe nxënësit marrin një arsimim të mirë të përgjithshëm dhe përgatiten për një profesion që ju përgjigjet aftësive të tyre.

Klasë të veçanta në vitin e fundit të shkollës fillore të lartë

Viti i përzgjedhjes të profesionit Berufswahljahr BWJ

Viti i përzgjedhjes të profesionit ju dedikohet nxënësve dhe nxënësve që për vendimmarrje për një profesion dhe të kërkimi i një vendi mësimor për një profesion ju nevojitet një mbështetje intensive. Është e hapur për të gjithë nxënëset dhe nxënësit e të gjitha llojeve të shkollës fillore të lartë.

Viti i punëtorisë Werkjahr WJ

Viti i punëtorisë merr praktikisht djemët dhe vajzat e talentuar të klasave të vogla apo dhe të shkollës Reale. Ata mbështeten që të gjejnë një vend për mësimim e një profesioni që ju përshtatet atyre apo që që gjejnë një veprimtari në profesion.

Klasa integruese dhe klasa për gjetjen e profesionit Integrations- und Berufsfindungsklasse IBK

Klasa integruese dhe klasa për gjetjen e profesionit ju drejtohet të rinjve që kanë emigruar dhe që janë maksimalisht dy vjet në Zvicër. Qëllimi i kësaj klase është që ta lehtësoj integrimin profesional dhe social të këtyre të rinjve. Nxënëset dhe nxënësit në klasën për integrim mund të i thellojnë njohurit e gjuhës gjermane dhe në lëndët e përgjithshme. Ata përgatiten intensivisht për zgjedhjen e një profesioni dhe aplikim për mësimin e një profesioni.



Masat nxitëse shtesë

Oferta për fëmijë të cilët nuk e kanë gjuhën e parë gjuhën gjermane

Mësimi-gjermanisht si gjuhë e dytë (kopshti i fëmijëve, shkolla fillore e ulët dhe e lartë) Deutsch als Zweitsprache DaZ

Fëmijët, te të cilët gjuha e parë nuk është gjuha gjermane, mësojnë në kopshtin parashkollor me fëmijët e tjerë dhe personelin mësimor gjermanisht. Nëse në një klasë ka shumë fëmijë që flasin një gjuhë tjetër, ata do të kenë mësim plotësues „gjermanisht si gjuhë e dytë“. Fëmijët të cilët përgjatë vitit të dytë në kopshtin parashkollor vinë në Zvicër, marrin në klasën e parë fillore të ulët mësim intensiv në gjuhën gjermane.

Fëmijët e tjerë të cilët përgjatë shkollës fillore të ulët apo shkollës fillore të lartë vinë në Zvicër marrin një vit të plotë mësim intensiv në gjuhën gjermane.

Përgjatë kopshtit parashkollor në mësimin intensiv të gjuhës gjermane marrin nxënëset dhe nxënësit dy apo tri vite të tjera mësim plotësues në gjuhën gjermane. Kjo ofertë vlen për të gjitha nivelet e shkollës fillore 9 vjeçare.

Kurse në gjuhën amtare dhe kultur (prej klasës të dytë)

Kurset në gjuhën amtare dhe kultur ofrohen prej ambasadave, konsulatave si dhe shoqatat e prindërve. Vijimi i këtyre kurseve preferohet shumë, sepse është me rëndësi që fëmijët të zotrojnë gjuhën e nënës dhe t'i thellojnë njohurit për vendin e ardhjes të prindërve të tyre.

Në kurset e gjuhës dhe kulturës të vendpreardhjes marrin pjesë vetëm fëmijët të cilët i paraqesin prindërit. Njoftime për këto kurse japin vendet kordinuese të ambasadave, konsulatave apo shoqatat e prindërve.

Njoftim: Sektion Entwicklung, Themenbereich Sprache und Migration, Tel. 062 835 21 18

Adresat e vendeve për kordinim: www.ag.ch/bildung > Unterricht & Schulbetrieb > Schule & Interkulturelles

Mësimi shërues për gjuhë


Për fëmijët me pengesa në gjuhë dhe të folur ofrohet mësim shërues për gjuhë. Kjo ofertë për prindër është falas.

Njoftim marrin prindërit te udhëheqja e shkollës apo nën: www.ag.ch/bildung > Sonderpädagogik & Förderangebote > Logopädie & Legasthenietherapie

Vështrim për nivelin sekondar II

Niveli sekondar II përmbledh arsimimin profesional, gjimnazin, shkollat e mesme profesionale, shkollën e mesme ekonomike, si dhe shkollën e mesme të informatikës.

Paraqitja e mëposhtme jep një vështrim për ndërtimin e shkollës sekondare II në kantonin e Aargaut. Grafika duhet të lexohet nga poshtë lartë.



Zgjidhjet kalimtare pas shkollës fillore nëntë vjeçare

Shumica e të rinjëve fillon pas 11 viteve të shkollimit të detyrueshëm me mësimin dhe ushtrimin e një profesioni, apo vijmin e një shkolle tjetër. Mirëpo disa të rinjëve ju nevojitet mbështetje shtesë për të gjetur një profesion. Për këtë ka zgjidhje kalimtare. Ato përbëhen prej ofertave urëlidhëse në shkollën kantonale për mësim të profesionit (ksb), si dhe semenstrave motivues (SEMO) në qendrën rajonale për ndërmjetësim në punë (RAV).

Brückenangebote të shkollës kantonale për mësim të profesionit

Të rinjët që kanë mësuar dhe ata që janë të gatshëm për suksese, të cilët e kanë përmbyllur nivelin e shkollës të lartë fillore dhe të cilët dëshirojnë intenzivisht të përgatiten për një arsimim bazë, kanë mundësin për këtë ta vijojnë një ofertë urëlidhëse në shkollën kantonale për mësim të një profesioni (ksb). Ky mësim që zgjatë një vit shërben për thellimin individual të arsimit të përgjithshëm po ashtu në nxitjen dhe zhvillimin e personalitetit si dhe integrimin soziokulturore. Të rinjët do të mbështeten gjatë kërkimit të një vendi për arsimim dhe profesion që ju përshtatet.

Motivationssemester

Semestri motivues (SEMO) i mbështet të rinjët dhe të papunët gjatë kërkimit të një vendi për arsimim apo të një mundësie tjetër për të hyrë në tregun e punës. Përcjell përvojat e para në punë dhe ndihmon në përpunimin e perspektivave të reja. Një semester motivues përbëhet nga arsimimi, puna, dhe ushtrimet për aplikim. Qendra rajonale ndërmjetësuese për punë (RAV) ndërmjetëson për punë të përshtatshme. Në shumicën e rastve semestret motivuese i udhëheqin shoqatat apo fondacionet.

Paraqitja

Hyrja në ofertat urëlidhëse dhe në semestrat motivues bëhet nëpërmes zyrës qendrore "Wegweiser". Të rinjët pa zgjidhje përfundimtare pas shkollës fillore nëntë vjeçare lajmërohen te zyra Udhërrëfyesi dhe do të udhëzohen në ofertën e përshtatshme për ta.

Departement Bildung, Kultur und Sport
Abteilung Berufsbildung und Mittelschule
Anlaufstelle Wegweiser
Kasinostrasse 29, Postfach 2254, 5001 Aarau
www.ag.ch/wegweiser
E-Mail: wegweiser@ag.ch, Tel. 062 835 41 40

Arsimimi profesional (Niveli Sekundar II)

Arsimimi bazë profesional Berufliche Grundbildung

Arsimimi bazë profesional është arsimimi i parë më i rëndësishmi në Zvicër. Ai ju mundëson të rinjëve hyrjen në frymën e punës dhe ndërmjetson për ta një bazë solide për profesion. Pranë arsimimit praktik në një ndërmarrje, vizitojnë ata që mësojnë një profesion një deri dy ditë në javë shkollën për arsimim profesional. Arsimimi zgjatë sipas profesionit që mësohet dy deri katër vjet.

- Arsimimi bazë që zgjatë tri apo katër vjet çon në marrjen e një dëftese të profesionit përkatës vendor eidgenössischen Fähigkeitszeugnis EFZ,
- Arsimimi bazë që zgjatë dy vjet çon në marrjen e një atesti të profesionit vendor eidgenössischem Berufsattest EBA.

Një profesion i mbaruar është një parakusht i rëndësishëm që më vonë në tregun e punës të kesh një siguri afatëgjatë. Ajo hap shumë perspektivë për profesion dhe mundësi për arsimim atraktiv të mëtejshëm.

Me përfundime të pranuar ju hapet ju hyrja në arsimimin e lartë (në bazën EFZ) apo te një arsimim tjetër bazë (në bazën EBA).

Informacione të tjera: www.ag.ch/berufsbildung



Shkolla e mesme profesionale Berufsmittelschule

Të rinjët e talentuar dha ata që dëshirojnë rezultate e që e absolutojnë një arsimim profesional, mundën që të bëjnë mësim të detyruar plotësues në shkollën profesionale dhe arsimimin e tyre ta përmbyllin me një maturë profesionale Berufsmaturität.

Absolventët dhe absolventet që marrin një maturë profesionale kanë një kualifikim të dyfishtë: Nga njëra anë janë persona me një profesion të pranuar nga ana tjetër ju mundëson matura profesionale studimin në një shkollë të lartë Fachhochschule.

Pranimi në shkollat e mesme profesionale rrjedh pa provim pranues sipas mesatarës të notave në vitin e fundit shkollor të shkollës Rajonale-apo Sekunadre ose me provim pranues.

Informacione të tjera për kushtet e pranimit në shkollat e mesme profesionale: www.ag.ch/mitelschulen

Informacione për arsimimin profesional dhe këshillime mund të merrni te këshillimoret për profesione dhe në info-qendrat përkatëse.



Shkollat e mesme (niveli Sekundar II)

Shkollat e mesme janë shkolla të cilat mund të vijohen pas njëmbëdhjetë vitesh të detyrura shkollore. Ato çojnë mvarësisht nga lloji i shkollës në matura të ndryshme dhe mundësojnë pranimin në shkolla të larta, shkolla profesionale të larta dhe universitete.

Shkolla e mesme profesionale dhe matura profesionale Fachmittelschule FMS und Fachmaturität FM

Shkolla e mesme profesionale përgatit për arsimim të vlefshëm në fusha të ndryshme profesionale. Në kantonin e Aargaut ofrohen katër fusha të arsimimit. Edukimi dhe krijimi, shëndetësia, puna sociale dhe komunikimi. SH.M.P zgjatë tri vjet dhe në mbarim lëshohet një dëftesë për mbarimin e shkollës të mesme profesionale e njohur në tërë Zvicrën. Në fund mundet të apsolvohet matura profesionale e cila mundëson hyrjen shkolla të larta profesionale në profesionin e zgjedhur.

Shkolla e mesme ekonomike Wirtschaftsmittelschule WMS

Shkolla e mesme ekonomike përgatit për profesione të ndryshe tregëtie. Pas tri vitesh në një shkollë dhe pas përmbylljes të një viti praktikë në një ndërmarrje merr njeriu një dëftesë vendore për profesionin përkatës tregëtar/tregëtare das Eidgenössische Fähigkeitszeugnis EFZ Kaufmann/Kauffrau dhe një maturë profesioni për tregëti kaufmännischen Berufsmaturität Kjo mundëson kalimin në një shkollë të lartë profesionale dhe në një vit arsimim kalim (krahaso Passerelle).

Shkolla e mesme e informatikës Informatikmittelschule IMS

Shkolla e mesme e informatikës kombinon arsimimin e përgjithshëm, arsimimin për informatikë dhe arsimin për tregëti. Pas tri vitesh shkollë dhe vitin e katërt praktikë në një ndërmarrje merr njeriu një dëftesë vendore për profesionin përkatës Informatikant/informatikante Eidgenössische Fähigkeitszeugnis EFZ Informatiker / Informatikerin drejtimi zhvillimi aplikativ dhe një maturë profesionale për tregëti. Kjo mundëson kalimin në një shkollë të lartë profesionale dhe në Passerelle (krahaso Passerelle).

Kushtet për pranim FMS / WMS / IMS

Pranimi në shkollën e mesme të pedagogjisë, artit, mjekësisë, gazetarisë, punës sociale ekonomisë dhe të informatikës bëhet pa provim pranues sipas mesatarës të notave në vitin e fundit shkollor të shkollës Rajonale apo Sekundare ose me provim pranues.

Informacione të tjera për kushtet e pranimit në shkollat e lartëpërmendura: www.ag.ch/mitelschulen

Gjimnazi Gymnasium

Arsimimi në gjashtë gjimnazet kantonale në Aargau zgjatë katër vjet dhe përmbyllet me një maturë Maturität. të pranuar vendore. Kjo të mundëson hyrjen në shkollat e larta të Zvicrës pa provim pranues. Kush dëshiron të studioj medicinën, duhet të kaloj provimin për pranim.

Pranimi në gjimnazë bëhet pa provim pranues sipas mesatarës të notave në vitin e fundit shkollor të shkollës Rajonale. Nxënëset dhe nxënësit të cilët mund të dëshmojnë një përfundim të shkollës të nivelit të shkollës Rajonale, e kanë në vitin e ardhshëm të përfundimit të shkollës fillore 9 vjeçare mundësinë të absolutojnë provimin pranues.

Informacione të tjera për kushtet e pranimit në gjimnazë: www.ag.ch/mitelschulen

Kalim Passerelle

Kalimi ju mundëson absolventeve dhe absolventve të mirë që të bëjnë një maturë profesionale dhe mund të kalojnë provime shtesë të cilat ju mundësojnë hyrjen në shkolla të larta dhe universitete. Një kalim i një provimi shtesë nuk është i barabartë me një maturë gjimnazi dhe nuk krijon të drejtën e përgjithshme për një studim në universitete jashtë vendit.

Shkolla me maturë e Aargaut për të rritur

Kjo maturë për të rritur është një arsimim përcjellës përgjatë zbatimit të profesionit, që çon drejt një mature gjimnazi vendore të pranuar e që zgjatë tri vite e gjysëm. Parakusht për të hyrë është mësimi me përfundim të një profesioni apo një ushtrim i një profesioni tri vjet. Mosha duhet të jetë më së paku 20 vjeç. Shkolla bëhet dy ditë kurse në ditët tjera ushtrohet profesioni.

Informacione të tjera: www.ame.ch



Shërbimet këshilluese

Shërbimi psikologjik i shkollës

Oferta për shërbim psikologjik të shkollës ju ofrohet fëmijëve dhe të rinjëve prej kopshtit parashkollor deri në mbarimin e shkollës fillore 9 vjeçare dhe personave përgjegjës për ta.

Arsyet për paraqitje në shërbimin psikologjik të shkollës mund të jenë:

- Kur një nxënës / nxënëse në shkollë është i mbingarkuar apo e kundërta,
- Kur një nxënës / nxënëse ka probleme me mësim
- Kur një nxënës / nxënëse ka sjellje jo të mirë që bie në sy
- Kur te fëmijët me të meta parashihet hyrja në shkollë për fëmijë me nevoja të veçanta apo me mësim integrues
- Kur në mes prindërve, personelit mësimor dhe fëmijës paraqitet një problem,
- Kur prindërit kanë pyetje për zhvillimin e fëmijës (p.sh. frika te fëmijët, agresiviteti, mos koncentrimi)
- Kur një fëmijë përjeton dhunë shtëpiake

Shërbimi psikologjik i shkollës për ata që kërkojnë këshilla është falas.

Për pyetje dhe probleme munden të prekurit, prindërit, pjesëmarrësit në edukim apo të rinjët prej moshës 14 vjeçare të paraqiten përmes telefonit apo me formular për paraqitje direkt te shërbimi psikologjik i shkollës.

Personeli mësimor dhe personat e tretë munden nxënëset dhe nxënësit t'i paraqesin te ky shërbim vetëm me lejen me shkrim nga prindërit.

Informacione të tjera: www.ag.ch/schulpsychologie

E-Mail: sp.volksschule@ag.ch

Regionalstellen des Schulpsychologischen Dienstes:

Aarau: E-Mail: spd.aarau@ag.ch, Tel. 062 835 40 00

Bad Zurzach: E-Mail: spd.zurzach@ag.ch, Tel. 062 835 41 00

Baden: E-Mail: spd.baden@ag.ch, Tel. 062 835 40 20

Rheinfelden: E-Mail: spd.rheinfelden@ag.ch, Tel. 062 835 40 40

Wohlen: E-Mail: spd.wohlen@ag.ch, Tel. 062 835 40 60

Zofingen: E-Mail: spd.zofingen@ag.ch, Tel. 062 835 40 90

Shërbimi psikiatrik për fëmijë dhe të rinjë

Shërbimi psikiatrik për fëmijë dhe të rinjë është nën udhëheqjen e mjekut. Ai i kontrollon trajton fëmijët e sëmurë psikikisht në moshën parashkollore atë shkollore dhe të rinjët. Paraqitja është e mundshme përmes prindërve, përmes të rinjëve vetë apo autoriteteve mbrojtëse për të rritur dhe fëmijë. Personave të tjerë nga një fushë e caktuar profesioni ju nevojitet pajtimi i prindërve.

Ambulanca rajonale ka në: Aarau, Baden, Rheinfelden und Wohlen.

Njoftime dhe paraqitja:

E hënë deri të premten, ora 8–12 dhe ora 13.30–17.30, rastet urgjente: 24 orë dhe 365 ditë

Kinder- und Jugendpsychiatrischer Dienst
Zentrales Ambulatorium für Kinder und Jugendliche ZAKJ
Postfach 432, 5201 Brugg
www.pdag.ch
E-Mail: kipd.zakj@pdag.ch, Tel. 056 462 21 20



ask! – Shërbimet këshilluese për arsimim dhe profesion në kantonin e Aargaut

Shërbimet këshilluese në Aargau Beratungsdienste Aargau (BDAG), mbështesin, nxisin dhe përcjellin njerëzit në zhvillimin personal dhe profesional. Shërbimet këshilluese për personat me banim apo arsimim në kantonin e Aargaut janë falas.

Profesioni zgjedhja e shkollës, profesioni bazë, shkolla e mesme, arsimimi profesional i mëtejshëm aplikimi, tregu i punës për të gjitha këto tema ka një material të shumtë informativ në gjashtë qendrat informative apo online.

Pranë këshillimit personal ka dhe një numër të madh të organizimit të mbrëmjeve informative për të rinjë dhe prindër. Për prindërit që flasin gjuhë të huaj ofrohen këto informacione në gjuhë të ndryshme përkatëse.

Informacione për të gjitha ofertat: www.bdag.ch

Kontakti te qendrat informative::

Aarau: E-Mail: blb@bdag.ch, Tel. 062 832 64 10

Baden: E-Mail: baden@bdag.ch, Tel. 062 832 65 10

Bad Zurzach: E-Mail: zurzach@bdag.ch, Tel. 062 832 65 60

Rheinfelden: E-Mail: rheinfelden@bdag.ch, Tel. 062 832 65 50

Wohlen: E-Mail: wohlen@bdag.ch, Tel. 062 832 65 70

Zofingen: E-Mail: zofingen@bdag.ch, Tel. 062 832 64 80

Zyra me ekip profesional 1155 Fachstelle Team 1155

Ekipi 1155 i mbështetë njerëzit e rinjë, që kanë vështërsi me gjetë një vend për mësimin e një profesioni prej hyrjes e deri në përfundim. Oferta është falas dhe me besim.

Informacione për ofertë: www.1155.ch

E-Mail: 1155@ag.ch, Tel: 0800 1155 00 (numri falas)

**Departement
Bildung, Kultur und Sport**

Abteilung Volksschule
Bachstrasse 15
5001 Aarau

Juni 2016